



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë ,më 11.06.2024

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

(“BLERJE GOMA PËR AUTOMJETET E BASHKISË KRUJË”)

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 11.06.2024 ne Kruje ,nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin nr. datë, me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar ”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje goma për automjetet e Bashkisë Krujë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34350000-5/(Goma per automjete te renda/lehta)

VLERA E FONDIT LIMIT: prej 1’874’600 (njemilion e teteqind e shtatedhjte e kater mije e gjashteqind) lekë pa t.v.sh

BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUJE .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;(ne masen prej 2% te vleres se fondit limit te kontrates)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrimeve te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2024 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2023 per secilin operator)*

Shenim-Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2024 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2023 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje

kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2021.2022.2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **749840 (shtateqind e dyzet e nente mije e teteqind e dyzet) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Pervoje e sukseshme ne levrimin e furnizimin e mallrave si me poshte:

1. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , me një vlerë jo me te vogel se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se vlera **374 920 (treqind e shtatedhjetë e kater mije e nenteqind e njetzet) leke pa t.v.sh,** dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Vlera ne kufirin e percaktuar ne VKM nr 285 date 19.05.2021, eshte percaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkine Kruje), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje dhe të mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkeses së AK. (Deklarate të leshuar nga Administratori i shoqërisë)

Kerkesat e mesiperme janë vendosur nga ana e AK në përputhje me nenin 44.2 e vijues të VKM nr 285 date 19.05.2021 nëpërmjet të cilave kërkohet që Kur autoriteti/enti kontraktor prokuror furnizime me karakteristika specifike ose specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

NR	EMËRTIMI I MATERIALIT/RREZJA	Mjeti	NJËSIA	Sasia	7 DITE	7 DITE
1	Goma 6/50/16 me gomordare	Kamionçine tip Iveco	Copë	4		
2	Goma 315/80/ R22.5	Kamion Iveco	Copë	4		
3	Goma 315/80/ R22.5	Kamion Benz	Copë	4		
4	Goma 10/00/R22.6	Kamion teknologjik Volvo	Copë	4		
5	Goma 16/70-20	Fadrome Terex	Copë	2		
6	Goma 16/9/30	Fadrome Terex	Copë	2		
7	Goma 360/80/20	Fadrome Hidromek	Copë	2		
8	Goma 440/80/28	Fadrome Hidromek	Copë	2		
9	Goma 235/75/R 17.5	Kamioncine benz (elektriku)	Copë	4		
10	Goma 225/70/R15 C	Kamioncine benz	Copë	4		
11	Goma 315/80/ R22.5	Kamion teknologjik Daf	Copë	4		
12	Goma 255/50/R 20	Fuoristrade benz ML 320 CD	Copë	2		
13	Goma 255/50/ R19	Fuoristrade Benz	Copë	4		
14	Goma 9/ R 22.5	Zjarrfikese tip Man 13-168	Copë	4		
15	Goma 10/ R 22.5	Zjarrfikese tip Iveco	Copë	2		
16	Goma 215/75/ R 16	Mjeti tip Ford Tranzit	Copë	2		
17	Goma 235/75/ R 16	Mitsubishi Pajero	Copë	1		
	SHUMA			51		

Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e artikujt të mesiperme është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve dhe Investimeve Publike që mban **nr.3569 Prot, date 06.06.2024**, duke identifikuar specifikimet standarte dhe karakteristikat përkatëse teknike të

cilat plotesojne nevojat respektive te Bashkise Kruje dhe me konkretisht ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te normave perkatese te Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 ‘‘Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore’’ , kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.

- **Fondi limit** per proceduren me objekt , **‘‘Blerje goma për automjetet e Bashkisë Krujë’’**, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , ‘‘Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik’’, i ndryshuar

PER NJESINE E PROKURIMIT PUBLIK

Eglantina SUBASHI

Melisa KUPA

Mikeda CACA